

Nr. 4 Regj.

Durrës, më 09. 04. 2025

Lënda: Në përgjigje të kërkesës suaj.***KËRKUESI INFORMACIONIT***

Në kuadër të implementimit të Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit” (i ndryshime), si dhe në referencë të kërkesës suaj, datë 07.04.2025, me objekt “Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit” e regjistruar në regjistrin e “Kërkesë/Ankesë/Përgjigje” në përputhje me nenin 8 të ligjit të sipërcituar me Nr. 4, ju informojmë për si vijon:

1. Cila është gjendja aktuale e punimeve për hekurudhën Tiranë-Durrës me zgjatim në Rinas?

Punimet për Projektin ‘Rehabilitimi i Linjës hekurudhore Durrës-Tiranë kanë arritur në masën 82% . Po punohet intensivisht në të gjithë linjën duke përfshirë dhe linjën e re në drejtim të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA), ku brenda muajit Shtator do të përfundojnë 100% punimet civile, përfshire shina, traversa, nderruese dhe sinjalistika e jashtme.

2. A ka nisur puna për ndërtimin e stacioneve të reja të hekurudhës?

Kontrata për ndërtimin e stacioneve të reja hekurudhore përgjatë linjës hekurudhore Durrës-Tiranë-Rinas, do të firmosët brenda këtij muaji (10 Prill 2025) dhe punimet do të fillojnë menjëherë në Prill 2025 dhe përfundojnë në Prill 2026.

3. Cila është planvendosja e stacionit të planifikuar në Rinas dhe në çfarë faze ndodhen punimet në këtë stacion?

Stacioni fundor i Rinasit ka pësuar një ndryshim nga pozicioni i mëparshëm. Planvendosja tashmë është në një pozicion të ri për arsye të zhvillimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA) sipas Master Planit të Ri të miratuar të tyre. Gjurma përfundimtare e stacionit hekurudhor të Aeroportit është duke u finalizuar dhe do të jetë saktësisht përballë Forcave Ajrore- Albcontrol.

4. Cilat janë pritshmëritë e projektit për vitin 2025?

Brenda këtij viti do të përfundojnë plotësisht punimet civile të të gjithë projektit si të linjës ekzistuese Durrës-Tiranë, ashtu edhe të Linjës së Re Hekurudhore që po ndërtohet në Aeroport. Gjithashtu në fund të vitit 2025 do të jenë të përfunduara gjysma e godinave hekurudhore.

**Autoriteti publik “Hekurudha Shqiptare” Sh.A, angazhohet në garantimin e të drejtës së informimit, si garanci kushetuese dhe vepron në mbështetje të ligjit Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të Drejtën e informimit” dhe trajton kërkesën tuaj në përputhje me Ligjin nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.*

Me konsideratë!

KOORDINATORI I TË DREJTËS SË INFORMIMIT

Domeniko SINJARI